R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2773/5 prot. Tiranë, më 09.11.2026

V E N D I M

Nr.48, datë 09.11.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Znj. (në vijim "ankuesja") ka paraqitur pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") ankesën e regjistruar me nr. 2773 prot., datë 02.10.2026, kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (në vijim "OSHEE" ose "Autoriteti Publik"), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, në datën 25.08.2026, znj. i është drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me një kërkesë për informacion, nëpërmjet së cilës ka kërkuar të dhëna lidhur me konsumin e energjisë elektrike nga subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare në zonat e Kurbinit dhe Krujës.

Autoriteti Publik/OSHEE në përgjigjen paraprake të kthyer për kërkuesin, ndër të tjera, ka parashtruar se: *"(...) në sistemet e administruara nga FSHU sh.a. nuk mbahet një kategorizim i posaçëm i klientëve jofamiljarë sipas veprimtarive të tilla si "Gurore", "Karrierë", "Prodhim/Përpunim inertesh" apo sipas kategorive të tjera të aktivitetit ekonomik. Për këtë arsye, nga të dhënat që administrohen nga FSHU sh.a. nuk është e mundur të gjenerohet një listë e klientëve duke përdorur si kriter kërkimi llojin e aktivitetit ekonomik të ushtruar prej tyre. Rrjedhimisht, nuk mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë grupi specifik i subjekteve të referuara në kërkesën tuaj dhe, mbi këtë bazë, të evidentohen emrat tregtarë, NIPT-et dhe të dhënat e tjera të kërkuara për këtë grup të veçantë klientësh. Në funksion të marrjes së informacionit të kërkuar, sugjerojmë që subjektet që ushtrojnë aktivitetet "Gurore", "Karrierë" ose "Prodhim/Përpunim inertesh" në zonat e përcaktuara në kërkesë të identifikohen paraprakisht pranë institucioneve kompetente që administrojnë të dhëna lidhur me regjistrimin dhe*

veprimtarinë ekonomike të subjekteve". Pas identifikimit të subjekteve dhe vënies në dispozicion të FSHU sh.a. të të dhënave të nevojshme identifikuese, veçanërisht emrit të subjektit dhe/ose NIPT-it, FSHU sh.a. mund të kryejë verifikimet përkatëse në sistemet e saj dhe të evidentojë, për sa është e mundur, për secilin subjekt të identifikuar, të dhënat që disponon lidhur me kontratën e furnizimit me energji elektrike.

Në të njëjtën përgjigje, autoriteti ka orientuar kërkuesen që të identifikojë paraprakisht subjektet nëpërmjet institucioneve kompetente dhe të përcjellë emrat tregtarë dhe/ose numrat unikë të identifikimit të tyre (NIPT), me qëllim kryerjen e verifikimeve në sistemet e administruara prej tij.

Në vijim, me anë të kërkesës për informacion të datës 11.09.2026, ankuesja i ka përcjellë Autoritetit Publik listën e 15 subjekteve tregtare, të identifikuara me emër dhe NIPT, të cilat sipas dokumentacionit të paraqitur prej saj disponojnë leje minerare aktive në zonën e Kurbinit (Mamurras, Droje) dhe Krujës[1], duke kërkuar nga OSHEE informacion mbi:

1. Sasinë totale të energjisë elektrike të konsumuar (e matur në kWh) për secilin prej subjekteve të listuara më poshtë përgjatë vitit 2025 (e ndarë në baza mujore ose vjetore);
2. Nivelin e tensionit (tension i mesëm apo tension i lartë) ku furnizohen këto subjekte specifike sipas pikave të tyre të lëshimit/matjes.

Ankuesja ka sqaruar shprehimisht se kërkesa nuk përfshin vlera monetare të faturave, çmime të kontratave të furnizimit apo elemente të tjera financiare, por kufizohet në të dhëna teknike mbi konsumin e energjisë elektrike dhe parametrat e furnizimit.

Në përgjigje të kësaj kërkese, OSHEE ka parashtruar se: *"Të dhënat mbi konsumin e energjisë elektrike të një klienti të identifikuar lidhen drejtpërdrejt me marrëdhënien e tij të furnizimit dhe faturimit. "Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë", të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, parashikojnë detyrimin e Furnizuesit për të garantuar konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe të faturimit. Në kontratë përcaktohet se të dhënat e faturimit përmbajnë, ndër të tjera, të dhënat identifikuese të klientit, të dhënat teknike të pikës së lidhjes, periudhën e faturimit, leximin e matësit dhe konsumin përkatës të energjisë elektrike.*

Gjithashtu, parametrat teknikë të furnizimit, përfshirë nivelin e tensionit, përbëjnë pjesë të kushteve individuale të furnizimit të klientit. Për rrjedhojë, lidhja e një subjekti tregtar të identifikuar me NIPT-in e tij me sasinë ekzakte të energjisë së konsumuar dhe nivelin përkatës të tensionit përbën dhënie të individualizuar të informacionit që buron nga marrëdhënia e tij e furnizimit dhe faturimit. Në vlerësimin e kërkesës është marrë në konsideratë gjithashtu neni 17 i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, sipas të cilit e drejta e informimit mund të kufizohet kur kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional për mbrojtjen e interesave të parashikuara nga ligji,

[1] Lista e subjekteve jofamiljarë: Kotica sh.p.k. (NIPT J97507310P); Al-GEM sh.a. (NIPT L11401018K); Antea Cement sh.a. (NIPT K61914005R); Minerave/Minierave sh.p.k. (NIPT L52306504G); Inerte Ekpres sh.p.k. (NIPT K72113012U); XYZ 08 sh.p.k. (NIPT K92110004Q); Priska sh.p.k. (NIPT J64416207W); Kegli-Duri sh.p.k. (NIPT K94016202U); Makaresh sh.p.k. (NIPT K24725213C); Met-Hasani sh.p.k. (NIPT K18430313I); DU&ER sh.p.k. (NIPT M08029302A); AE Goup sh.p.k. (NIPT L42230012O); ALION sh.p.k. (NIPT K32803014D); BB Group Construction sh.p.k. (NIPT M03902201G); Aghak Cara sh.p.k. (NIPT M07508301P).

ndër të tjera edhe të sekretit tregtar. Publikimi i konsumit të saktë vjetor të energjisë elektrike të lidhur drejtpërdrejt me secilin subjekt tregtar, veçanërisht i shoqëruar me informacionin mbi nivelin e tensionit, përveçse përbën informacion individual të faturimit, mund të mundësojë nxjerrjen e të dhënave apo përfundimeve mbi shkallën, intensitetin dhe karakteristikat e aktivitetit ekonomik të subjektit. Për këtë arsye, dhënia e tij në një formë të individualizuar do të cenonte konfidencialitetin që Furnizuesi është i detyruar të garantojë në marrëdhënien me klientët e tij. Për sa më sipër, duke vlerësuar natyrën e informacionit të kërkuar, detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të klientit dhe të faturimit, si dhe kufizimet e parashikuara nga neni 17 i ligjit nr.119/2014, informacioni mbi sasinë ekzakte të konsumit të energjisë elektrike dhe nivelin e tensionit për secilin subjekt të identifikuar nuk mund të vihet në dispozicion në formën individuale të kërkuar".

Kundër këtij qëndrimi, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit, duke pretenduar se refuzimi është i pambështetur në ligj, se autoriteti ka mbajtur një qëndrim kontradiktor gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe se nuk ka kryer analizën e domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe interesit publik përpara kufizimit të së drejtës për informim.

Ankuesja ka argumentuar gjithashtu se informacioni i kërkuar nuk përbën të dhënë personale, pasi lidhet me persona juridikë, dhe se autoriteti nuk ka provuar ekzistencën e një sekreti tregtar konkret, duke potencuar lidhjen e informacionit të kërkuar me transparencën mjedisore dhe kontrollin publik mbi veprimtaritë minerare.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në ankesën objekt shqyrtimi, vlerësoi se ajo përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 2773/1 prot., datë 09.10.2026, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankueses, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 9389/1 prot., datë 13.10.2026, ka kthyer përgjigje duke ripërsëritur argumentet lidhur me konfidencialitetin e të dhënave të furnizimit dhe faturimit, duke sqaruar se përgjigjet e dhëna në dy momentet procedurale nuk janë kontradiktore, por mbështeten në objektin dhe informacionin e disponueshëm në secilën fazë të shqyrtimit.

Gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI-së, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e*

ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me shkresën nr. 2773/3 prot., datë 19.10.2026, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua në datën 22.10.2026, në prezencën e përfaqësuesve të Autoritetit Publik dhe në mungesë të ankueses e cila, ndonëse u njoftua rregullisht në përputhje me nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nuk u paraqit në seancë. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, z. , me detyrë jurist pranë OSHEE-së, dhe z. , në cilësinë e koordinatorit të së Drejtës për Informim, kërkuan kohë për të rivlerësuar qëndrimin e autoritetit.

Në vijim, nëpërmjet *email*-it të datës 27.10.2026, z. ka njoftuar zyrën e Komisionerit se pas konsultimit të çështjes objekt shqyrtimi qëndrimi i Autoritetit Publik mbetet i njëjtë me atë të reflektuar si në përgjigjen e kthyer ndaj kërkesës për informim, ashtu edhe në atë të mbajtur në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Zyra e Komisionerit.

Në eventualitetin e këtyre fakteve, pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, Komisioneri vëren se për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 ka përcaktuar se: *"Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike"*. Për qëllimet e këtij ligji, rëndësi të veçantë merr edhe përkufizimi i Autoritetit Publik në nenin 2, pika 1 e LDI-së, ku parashikohet se: *""Autoritet publik": a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj"*. Në kuptim të këtij parashikimi, OSHEE është subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Gjithashtu, Komisioneri çmon të sjellë në vëmendje përcaktimin në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së, e cila parashikon se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

Në interpretim të kësaj dispozite, çmohet se çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, përmbajtja e të cilave reflekton veprimtarinë e organeve shtetërore dhe kërkesa për informim aktivizon detyrimin e Autoritetit Publik për të dhënë informacionin e kërkuar, përveç rasteve kur vetë ligji parashikon ndryshe.

Për rrjedhojë, ankuesja legjitimohet të kërkojë informacionin objekt shqyrtimi, ndërsa vënia e tij në dispozicion i nënshtrohet vetëm kufizimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, veçanërisht nga neni 17 i LDI-së.

Gjithashtu, LDI ka përcaktuar se, në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të përcaktuara në nenin 15, ose brenda afateve të përcaktuara në ligje të posaçme, do të konsiderohet refuzim.

Nga interpretimi sistematik i këtyre dispozitave rezulton se ligjvënësi ka përqafuar parimin e aksesit maksimal në informacionin publik, ndërsa kufizimet përbëjnë përjashtime nga rregulli i përgjithshëm i transparencës dhe, si të tilla, duhet të interpretohen *stricto sensu*.

Në rastin konkret, vlerësohet se OSHEE plotëson kriteret e nenit 2, pika 1, shkronja "b", të LDI-së, për rrjedhojë i nënshtrohet detyrimeve që rrjedhin prej tij. Në këtë optikë, fakti që informacioni lidhet me marrëdhënie kontraktore të një klienti fundor nuk e përjashton automatikisht atë nga koncepti i informacionit publik, kur të dhënat administrohen nga një autoritet që i nënshtrohet ligjit për të drejtën e informimit. Përkundrazi, është pikërisht natyra e informacionit, interesi që ai përfaqëson dhe dëmi konkret që mund të shkaktojë publikimi i tij ato që duhet të përcaktojnë nëse dhe në çfarë mase mund të kufizohet aksesi.

Neni 17, pika 1 e LDI-së, parashikon se e drejta për informim mund të kufizohet kur kufizimi është i domosdoshëm, proporcional dhe kur dhënia e informacionit dëmton interesat e mbrojtura shprehimisht nga ligji, ndër të cilat përfshihet edhe sekreti tregtar.

Nga formulimi i kësaj dispozite rezulton se zbatimi i kufizimit kushtëzohet nga plotësimi kumulativ i disa kritereve juridike, konkretisht: (i) ekzistenca e një interesi të ligjshëm, të mbrojtur nga dispozita; (ii) mundësia reale që dhënia e informacionit të cenojë këtë interes; (iii) domosdoshmëria e kufizimit për mbrojtjen e interesit përkatës; (iv) proporcionaliteti ndërmjet masës kufizuese dhe dëmit që synohet të parandalohet; (v) vlerësimi i ekzistencës së një interesi publik më të lartë për dhënien e informacionit.

Në këtë këndvështrim, barra e argumentimit dhe e justifikimit të kufizimit i përket autoritetit publik që e aplikon atë, në përputhje me standardin e kërkuar nga neni 17 i LDI-së.

Duke iu rikthyer rrethanave të faktit, Zyra e Komisionerit, në analizë të akteve e provave shkresore të administruara gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, si dhe kuadrit ligjor rregullator, vëren se informacioni i kërkuar përbën informacion publik, në përmbushje të kërkesave të pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, ku parashikohet se: *"'Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik"*. Për rrjedhojë, informacioni mbi sasinë totale të energjisë elektrike të konsumuar nga secili prej subjekteve të identifikuara gjatë vitit 2025, të shprehur në kWh, si dhe mbi nivelin e tensionit të furnizimit, nuk përjashtohen *a priori* nga fusha e së drejtës së informimit.

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik, në mënyrë konsistente përgjatë hetimit administrativ, pretenduan se publikimi i të dhënave mbi konsumin e energjisë elektrike dhe nivelin e tensionit do të ekspozonte subjektet ekonomike të listuara në kërkesën e znj. , në nxjerrjen e përfundimeve mbi shkallën dhe intensitetin e aktivitetit ekonomik të realizuar prej tyre.

Komisioneri vlerëson se ky argument, ndonëse identifikon një mundësi teorike të cenimit të interesave ekonomikë, nuk shoqërohet me një analizë të individualizuar mbi natyrën e

dëmit, probabilitetin e realizimit të tij, rëndësinë e pasojave dhe lidhjen shkakësore ndërmjet publikimit të të dhënave dhe cenimit të pretenduar.

Po ashtu, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar se si të dhënat e konsumit në kWh përbëjnë, në vetvete, informacion me karakter konfidencial të mbrojtur nga një interes ekonomik i ligjshëm dhe as se si publikimi i tyre do t'i shkaktonte një dëm konkret dhe të identifikueshëm secilit prej subjekteve të listuar në kërkesën për informacion objekt shqyrtimi. Për më tepër, Autoriteti Publik nuk ka evidentuar në mënyrë specifike se cilat elemente të informacionit të kërkuar janë të mbrojtura, çfarë natyre ka dëmi që mund të shkaktohet dhe pse ky dëm nuk mund të parandalohet nëpërmjet një mase më pak kufizuese, pra nuk rezulton të ketë identifikuar në mënyrë të qartë e të plotë interesat në konflikt.

Në këto kushte, Komisioneri çmon se arsyetimi i paraqitur nga OSHEE nuk përmbush standardin e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të përcaktuar në nenin 17 të LDI-së.

Përpos sa më sipër, në trajtimin e kësaj çështjeje, Komisioneri çmon të nevojshme të nënvizojë tiparet e informacionit konfidencial dhe sekretit tregtar, pasi këto koncepte nuk mund të përdoren në mënyrë të përgjithshme për të justifikuar kufizimin e aksesit në informacion. Po ashtu, vlerësohet me rëndësi të potencohet se karakteri teknik i informacionit nuk e përjashton apriori mundësinë që ai të jetë me natyrë tregtare apo konfidenciale, por këto cilësi duhet të provohen dhe të vlerësohen në mënyrë konkrete dhe jo të prezumohen vetëm për shkak të ekzistencës së një kontrate, përmbajtja e së cilës në asnjë rast nuk do të prevalonte mbi përcaktimet ligjore.

Së pari, informacioni i kërkuar lidhet me 15 subjekte tregtare të organizuara si persona juridikë, të identifikuara në kërkesë nëpërmjet emrit dhe NIPT-it. Në këtë kontekst, të dhënat mbi konsumin e energjisë elektrike të një shoqërie tregtare mund të gëzojnë mbrojtje sipas dispozitave të posaçme për sekretin tregtar dhe interesat e ligjshëm ekonomikë. Në rastin objekt shqyrtimi, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar dhe as nuk ka paraqitur prova se konsumi i energjisë elektrike, i shprehur në kWh, dëmton interesin e mbrojtur nga neni 17 në drejtim të sekretit tregtar.

Komisioneri vërën se kërkuesja ka përjashtuar shprehimisht nga objekti i kërkesës informacionin mbi të dhënat financiare, çmimet e furnizimit, vlerat e faturave dhe kushtet ekonomike të kontratave, por vetëm të dhëna teknike të konsumit dhe parametrat e furnizimit.

Së dyti, lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik për ekzistencën e konfidencialitetit kontraktor, Komisioneri vlerëson se ekzistenca e një detyrimi kontraktor për ruajtjen e konfidencialitetit nuk mund të interpretohet si një përjashtim i pavarur dhe absolut nga zbatimi i LDI-së. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, duhet të interpretohen në harmoni me normat ligjore që garantojnë transparencën dhe të drejtën e informimit.

Për më tepër, nga përmbajtja e shkronjës "g" të nenit 7 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, rezulton detyrimi i furnizuesit që gjatë sigurimit të aksesit *online* të faturës së konsumit të sigurojë që ky akses të jepet në mënyrë të tillë që të ruhet konfidencialiteti i të dhënave të klientit dhe faturimit. Pra, konfidencialiteti në këtë pikë lidhet vetëm me mënyrë se si aksesohet fatura *online* nga konsumatori dhe jo me detyrime të tjera që mund të lindin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi.

Komisioneri vlerëson se një akt nënligjor apo një klauzolë kontraktore nuk mund të krijojë një regjim përjashtimi më të gjerë sesa ai që parashikohet nga ligji, as të neutralizojë garancitë ligjore të aksesit në informacion, por në çdo rast nevojitet përcaktimi i raportit ndërmjet interesit të ligjshëm ekonomik të subjekteve tregtare dhe interesit publik për transparencën (në rastin konkret të veprimtarive minerare në zonat e Kurbinit dhe Krujës).

Në çështjen objekt shqyrtimi, subjektet e identifikuara ushtrojnë veprimtari minerare dhe përpunimi inertesh, veprimtari të cilat lidhen me shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe potencialisht me ndikime të rëndësishme mbi mjedisin, territorin dhe komunitetet përreth. Për rrjedhojë, informacioni mbi parametrat e konsumit të energjisë elektrike mundëson një nivel më të lartë transparence dhe krijon kushte për verifikimin e informacionit në raport me dokumentacionin e lejeve minerare, lejeve mjedisore dhe detyrimeve të tjera sektoriale. Në këtë drejtim, rëndësi merr edhe fakti se ankuesja ka identifikuar paraprakisht subjektet për të cilat kërkon informacionin dhe ka kufizuar periudhën kohore në vitin 2025, duke e bërë kërkesën të përcaktuar dhe të verifikueshme.

Në raport me këtë interes publik, OSHEE nuk ka paraqitur një analizë që të provojë se dëmi i mundshëm nga publikimi i të dhënave është më i rëndë sesa interesi publik që realizohet përmes transparencës.

Neni 17, pika 1 e LDI-së, parashikon shprehimisht se informacioni nuk refuzohet kur ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Ky parashikim përbën një mekanizëm korrigjues ndaj zbatimit mekanik të kufizimeve dhe kërkon nga Autoriteti Publik që të shqyrtojë jo vetëm interesin që synohet të mbrohet nëpërmjet mosdhënies së informacionit, por edhe rëndësinë e interesit publik që realizohet përmes transparencës.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se çështja duhet të analizohet edhe në dritën e garancive të posaçme që ofron legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit. Konkretisht, neni 56 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e gjithsecilit për t'u informuar mbi gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij[2]. Po ashtu, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Aarhusit nëpërmjet ligjit nr. 8672, datë 26.10.2000[3], duke marrë përsipër detyrimin për të garantuar aksesin e publikut në informacionin mjedisor. Në nenin 4 të kësaj Konvente përcaktohet detyrimi i autoriteteve publike për të vënë në

[2] *Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij*.
[3] Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 për ratifikimin e *"Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit"*.

dispozicion informacionin mjedisor, pa qenë e nevojshme që kërkuesi të deklarojë interesin e tij.

Në të njëjtën kohë, neni 4, pika 4, shkronja "d", njeh mundësinë e kufizimit për mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit tregtar dhe industrial, kur ky konfidencialitet mbrohet nga legjislacioni për të garantuar një interes ekonomik të ligjshëm. Megjithatë, kjo dispozitë kërkon interpretim në harmoni me detyrimet e transparencës mjedisore dhe parashikon posaçërisht publikimin e informacionit mbi shkarkimet në mjedis, kur ai është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit. Nga ana tjetër, jo çdo informacion që lidhet me një subjekt që ushtron aktivitet minerar mund të klasifikohet automatikisht si informacion mjedisor. Për këtë qëllim, duhet të vlerësohet lidhja konkrete e të dhënave të kërkuara me elementet, faktorët, masat apo veprimtaritë që ndikojnë ose mund të ndikojnë në mjedis.

Megjithatë, ai mund të përbëjë informacion me rëndësi për vlerësimin e veprimtarisë ekonomike dhe të përdorimit të energjisë në një sektor me ndikim potencial mbi mjedisin, në kuptim të objektivave të transparencës mjedisore.

Në të njëjtën linjë, ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, në nenin 13 përcakton të drejtën e çdo personi për të marrë në kohë informacion mbi gjendjen e mjedisit, ndotjen dhe masat e marra për mbrojtjen e tij.

Gjithashtu, parimet e parashikuara në nenet 6, 7, 8 dhe 12 të këtij ligji, përkatësisht zhvillimi i qëndrueshëm, parandalimi, ruajtja e burimeve natyrore dhe parimi "ndotësi paguan", përbëjnë elemente orientuese në interpretimin e interesit publik për transparencë mbi veprimtaritë që shfrytëzojnë burimet natyrore.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankueses për rëndësinë mjedisore të informacionit duhet të merret në konsideratë si element i vlerësimit të interesit publik, pa u zgjeruar përtej fushës së zbatimit të Konventës dhe të legjislacionit mjedisor, por gjithsesi në raport edhe me parashikimin në nenin 17, pika 6, të ligjit nr. 119/2014, i cili përcakton se nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit.

Komisioneri vëren se Autoriteti Publik ka refuzuar në mënyrë të njëjtë të dy kategoritë e informacionit të kërkuar, përkatësisht konsumin e energjisë elektrike në kWh dhe nivelin e tensionit të furnizimit, pa bërë një vlerësim të diferencuar të natyrës dhe ndjeshmërisë së tyre ndaj publikimit dhe mundësisë së cenimit të interesave ekonomikë të subjekteve përkatëse, çka vjen në kundërshtim me përcaktimin në dispozitën e sipërpërshkruar.

Lidhur me parashtrimin e ankueses se OSHEE ka mbajtur një qëndrim kontradiktor, pasi fillimisht ka orientuar kërkuesen të identifikojë subjektet me emër dhe NIPT dhe pas përcjelljes së këtyre të dhënave ka refuzuar dhënien e informacionit, nga shqyrtimi i akteve rezulton se përgjigjja fillestare e autoritetit lidhej me pamundësinë teknike të identifikimit të klientëve nëpërmjet kategorisë së aktivitetit ekonomik, për shkak të mënyrës së organizimit të sistemeve të administrimit të të dhënave.

Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se dy përgjigjet nuk janë domosdoshmërisht kontradiktore në aspektin formal, pasi kanë të bëjnë me dy çështje të ndryshme: identifikimin e klientëve dhe kufizimin e aksesit në informacionin e individualizuar.

Megjithatë, Autoriteti Publik, në momentin kur ka orientuar ankuesen të përcjellë të dhënat identifikuese, ka pasur detyrimin të shqyrtojë kërkesën në mënyrë të plotë, objektive dhe në përputhje me parimet e transparencës, mirëbesimit dhe sigurisë juridike.

Fakti që informacioni i kërkuar u identifikua nëpërmjet NIPT-eve, nuk e përjashtonte autoritetin nga detyrimi për të kryer testin e kufizimit sipas nenit 17 të ligjit nr. 119/2014.

Për rrjedhojë, Komisioneri çmon se sjellja procedurale e autoritetit duhet të vlerësohet në raport me detyrimin për administrim të kujdesshëm dhe të parashikueshëm të kërkesës, por jo të konsiderohet në vetvete qëndrim kontradiktor apo cenim i parimit të mirëbesimit, sikurse ka pretenduar ankuesja.

Në interpretimin e standardeve që burojnë nga e drejta për të marrë informacion, Komisioneri çmon të marrë në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, veçanërisht praktikën e zhvilluar në kuadër të nenit 10 të Konventës. Konkretisht, në çështjen *Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë*[4], Gjykata ka konsoliduar kriteret për përcaktimin e rrethanave në të cilat refuzimi i aksesit në informacionin e administruar nga autoritetet publike mund të përbëjë ndërhyrje në të drejtën e garantuar nga neni 10 i Konventës. Në këtë optikë, Gjykata ka identifikuar si kritere kryesore: (i) qëllimin e kërkesës për informacion; (ii) natyrën e informacionit të kërkuar; si dhe (iii) rolin e kërkuesit. Në çështjen objekt shqyrtimi, këto kritere marrin rëndësi të veçantë, pasi informacioni kërkohet për të mundësuar informimin e publikut mbi veprimtarinë e subjekteve që shfrytëzojnë burimet minerare si dhe, për më tepër, informacioni kërkohet nga një gazetare.

Në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*[5], Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ") ka theksuar rëndësinë e aksesit në informacionin e disponueshëm për ushtrimin e funksionit të mbikëqyrësit publik (*public watchdog*), veçanërisht kur informacioni përbën një hap paraprak të domosdoshëm për pjesëmarrjen në debatin publik.

Po kështu, në çështjen *Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung und Schaffung eines wirtschaftlich gesunden land- und forstwirtschaftlichen Grundbesitzes kundër Austrisë*[6], GJEDNJ ka analizuar aksesin në dokumentacionin e administruar nga një organ publik, duke shqyrtuar natyrën e kërkesës dhe rolin e informacionit për debatin publik.

Komisioneri vlerëson se këto standarde nuk nënkuptojnë njohjen e një të drejte të pakufizuar për akses në çdo informacion të administruar nga autoritetet publike. Ato

[4] Kërkesa nr. 18030/11, vendim i Dhomës së Madhe, datë 08.11.2016.
[5] Kërkesa nr. 37374/05, vendim datë 14.04.2009.
[6] Kërkesa nr. 39534/07, vendim datë 28.11.2013.

kërkojnë që në çdo rast kufizimet të shqyrtohen në mënyrë konkrete, në dritën e natyrës së informacionit dhe rolit që ai luan në interesin publik.

Për pasojë, refuzimi i përgjithshëm i informacionit, pa një analizë të mjaftueshme të interesave në konflikt, nuk përputhet me standardin e një shoqërie demokratike, ku transparenca dhe llogaridhënia përbëjnë elemente themelore të qeverisjes së mirë.

Në funksion të interpretimit krahasues të standardeve të transparencës mjedisore dhe mbrojtjes së interesave tregtarë, Komisioneri merr në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (në vijim "GJDBE").

Në çështjen *Komisioni Evropian kundër Stichting Greenpeace Nederland dhe PAN Europe, C-673/13 P*[7], GJDBE ka analizuar raportin ndërmjet aksesit në dokumentacionin mjedisor dhe mbrojtjes së interesave tregtarë. Po ashtu, GJDBE ka theksuar rëndësinë e ruajtjes së ekuilibrit ndërmjet transparencës dhe mbrojtjes së interesave ekonomikë, duke sqaruar se koncepti i informacionit mbi shkarkimet në mjedis nuk mund të interpretohet në mënyrë aq të gjerë sa të përfshijë çdo informacion që ka lidhje me mjedisin.

Ky standard është relevant në çështjen objekt shqyrtimi, pasi në çështjen konkrete arsyetimi i OSHEE-së mbështetet kryesisht në një interpretim të përgjithshëm të konfidencialitetit të të dhënave të furnizimit, pa identifikuar dëmin konkret që do të shkaktonte publikimi i informacionit të kërkuar.

Gjithashtu, Autoriteti Publik nuk ka dokumentuar kryerjen e një analize të veçantë për secilën prej dy elementeve të informacionit, as të një vlerësimi të argumentuar të interesit publik përkundrejt detyrimit për transparencë.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i autoritetit nuk përmbush standardin e arsyetimit të kërkuar për zbatimin e një kufizimi të së drejtës për informim.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri arrin në konkluzionin se e drejta për informim nuk mund të kufizohet mbi bazën e një prezumimi të përgjithshëm se çdo e dhënë e lidhur me marrëdhënien e furnizimit me energji elektrike përbën informacion konfidencial.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se mbrojtja e sekretit tregtar është një interes legjitim, por zbatimi i tij kërkon identifikimin e informacionit konkret që gëzon këtë mbrojtje dhe provimin e dëmit të mundshëm që do të shkaktonte publikimi.

Në rastin konkret, OSHEE nuk ka arritur të argumentojë në mënyrë të individualizuar se dhënia e konsumit të energjisë elektrike në kWh dhe e nivelit të tensionit për secilin subjekt do të shkaktonte një dëm konkret, të identifikueshëm dhe proporcional me kufizimin e së drejtës për informim. Për më tepër, autoriteti nuk ka vlerësuar mundësinë e dhënies së pjesshme të informacionit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 119/2014.

[7] *Case C-673/13 P, Judgment of the Court (Fifth Chamber) 23 November 2016* https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:62013CJ0673

Komisioneri çmon se interesi publik për transparencë mbi veprimtarinë e subjekteve që shfrytëzojnë burimet natyrore në zonat e identifikuara duhet të përfshihet në mënyrë substanciale në vlerësimin e interesave në konflikt.

Në këto rrethana, refuzimi në tërësi i kërkesës për informacion nuk rezulton i mbështetur në një zbatim të drejtë dhe proporcional të kufizimeve të parashikuara në pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Në përfundim, Komisioneri çmon të nënvizojë se e drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, si dhe shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesës me nr. 2773 prot., datë 05.10.2026, të znj. , kundër Autoritetit Publik "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik që t'i vendosë në dispozicion ankueses informacionin e kërkuar për 15 subjektet e identifikuara në kërkesën e datës 11.09.2026, konkretisht: *Sasinë totale të energjisë elektrike të konsumuar gjatë vitit 2025, të shprehur në kWh, sipas të dhënave të administruara në sistemet përkatëse; Nivelin e tensionit të furnizimit për secilin subjekt, sipas pikave përkatëse të lidhjes/matjes*, brenda datës 16.11.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 09.11.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi